1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

**23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës** 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

**25. Procedura e ankesës** 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

- 
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

**SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.



---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.	“Furnizime dhe shërbime me ushqim për menca, për nevoja të Qendrës Komunitare Strehëza”	30 racione për 365 ditë nga e hëna në të dielë. Racione total 10.950.			365 ditë.
				<b>Çmimi total</b>	_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* ]

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [ emri i ofertuesit të siguruar ] ka derdhur një depozitë pranë [ emri dhe adresa e bankës ] / është garantuar pranë [ emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit ] me një vlerë prej [ monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra ] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

**Shtojca 5.**

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6 .

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Bashkëlidhur DST Termat e Referencës.

## Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Furnizime dhe shërbime me ushqim për menca për nevoja të Qendrës Komunitare Strehëza”.**

Qëllimi i këtij shërbimi është ndër të tjera t'u ofrojë personave në situatë rruge apo në kushte emergjence edhe mensë sociale/ushqim 2 vakte, mëngjes dhe darkë për 365 ditë të vitit.

**Afatet e ekzekutimit:** Kohëzgjatja në muaj 12 muja ose 365 ditë. Afati kohor i ofrimit të shërbimit do të jetë për një periudhë kohore 12 (dymbëdhjetë) muaj/ 1 (një) vit/ 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, duke filluar nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1.	“Furnizime dhe shërbime me ushqim për menca për nevoja të Qendrës Komunitare “Strehëza”	30 racione për 365 ditë nga e hëna në të dielë. Racione total 10.950.	Per nevoja te organit perfitues Qendra Komunitare “Streheza”	365 dite



## Shtojca 8.

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

**Termat e references të hartuara për procedurën e prokurimit me objekt: “Furnizime dhe shërbime me ushqim për menca” për nevoja të Qendrës Komunitare ”Strehëza”.**

Detyra kryesore funksionale të Qendrës Komunitare Strehëza konform VKB Nr.112 dt 27.09.2018 për “Krijimin e Qendrës Sociale “Strehëza” janë si më poshtë vijon:

- Akomodim i përkohshëm (fjetje) për personat në situatë rruge dhe në raste emergjence;
- Sigurim i paketës së shërbimeve bazë: higjienë, **mensë sociale**, kujdes shëndetësor e psiko-social;
- Shërbime këshilluese, ndërmjetësuese lidhur me statusin civil, strehimin social, punësimin dhe aspekte ligjore;
- Parandalim i braktisjes, institucionalizimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore;
- Integrimi i individëve me probleme sociale dhe të zhvillimit;
- Ofrimi i programeve të fuqizimit të individit dhe familjes;
- Sigurim i një mënyre jetese të shëndetshme e të pavarur për personat me aftësi të kufizuar;

Termat e referencës hartohen si të tilla edhe referuar nevojave të Autoritetit Kontraktor, i cili merret ndër të tjera edhe me sigurimin e ushqimit për personat në situatë rruge dhe në raste emergjence dhe paraqiten si më poshtë vijon:

Përshkrimi i të dhënave teknike të shërbimeve është bërë në mënyrë të tillë për të krijuar kushte për konkurrim të paanshëm, është bërë nga specialisti i fushës, pjesë e grupit të punës dhe detajohen si më poshtë vijon:

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me furnizimin me ushqim:**

1. Vlera e përlogaritur për person do të jetë 430 (treqind) leke pa tvsh për shpenzimet ditore të ushqimeve për personat në situatë rruge apo të ndodhur në rrethana emergjente. Kjo kuotë është miratuar me anë të VKB-së Nr. 31 datë 28.03.2024 për “Miratimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendrat komunitare dhe rezidenciale të përkujdesit shoqëror, në varësi të Bashkisë Tiranë”, pika 2.
2. Fokusi kryesor i këtij institucioni është dhënia e vaktit të mëngjesit dhe të darkës për 365 ditë për përfituesit në gjendje rruge.
3. Numri maksimal i racioneve të porositura do të jetë jo më shumë së 30 racione
4. Qendra Sociale do të njoftojë në orën 12: 00 për numrin e saktë të racioneve që do të porositen.
5. Qendra Sociale do të furnizohet me Ushqim të Gatshëm nga e Hëna në të Dielë në orën 07.00 mëngjesi, dhe ora 20.00 darka.
6. Qendra do të pajiset çdo ditë me një faturë provizore ku do të cilësohen numri i menuve të mara në dorëzim, cmimi, si dhe vlera në lekë e ushqimit të sjell.

### **Kërkesa të Përgjithshme**

Operatori ekonomik është i detyruar të zbatojë procedurat e menaxhimit të ushqimit të kërkuara në urdhrin e Titullarit të Autoritet Kontraktor.

- 
- Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 30 veta per vaktin e mëngjesit dhe darkës, sipas orareve të përcaktuara.
  - Operatori ekonomik të sigurojë e disponojë në guzhinë, mjete matëse të sasisë të certifikuara nga inspektorati i kalibrimit të njësive matëse.
  - Çdo ditë përfaqësues të operatorit ekonomik do të rakordojnë me personin e ngarkuar nga titullari i Qendrës Sociale për hartimin e forcës ditore të ushqimit dhe për konsumin e tij, në Qendrën Sociale.
  - Operatori ekonomik, nuk mund të transferojë, kalojë pa pëlqimin e autoritetit kontraktor, detyrimet e tij, kontraktuale një pale të tretë.
  - Operatori ekonomik do të paraqesë në fund të çdo muaji faturën dhe dokumentacionin justifikues për sasinë e mallrave të furnizuar dhe shërbimin e ofruar.

**Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 30 veta per vaktin e mëngjesit edhe të darkës, sipas orareve të përcaktuara.**

1. Banjomarina
2. Tabaka - 30 copë
3. Lugë - 30 copë
4. Pirunj - 30 copë
5. Tas per supën - 30 copë
6. Pjata gjelle - 30 copë
7. Pjata të vogla - 30 copë
8. Gota uji - 30 copë
9. Mushama
10. Letra
11. Ndarëset e ushqimit (garuzhde etj)

**Kërkesa teknike për përgatitjen e ushqimit dhe sigurinë ushqimore.**

**Siguria ushqimore**

Të gjithë artikujt ushqimorë që do të përdoren për gatim do të jenë të cilësisë së parë, të freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndët e para të përcaktuara në këtë dokument.

Ushqimi të jetë i gatuar në çast, racioni ditore duhet të përmbajë sasinë e duhura të artikujve sipas listës së menusë javore dhe ditore, ushqimi të shpërndahet i ngrohtë sipas orareve të përcaktuara nga Administrata e Qendrës Sociale Strehëza.

Në asnjë rast nuk do të lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimorë, që janë përcaktuar në normën bazë të ushqimit, me përjashtim të rasteve të fatkeqësive natyrore apo të fuqisë madhore.

**MENAXHIMI I SHËRBIMIT NGA AUTORITETI KONTRAKTOR**

Të verifikojë për vaktin e mëngjesit dhe darkës, numrin e personave që trajtohen me ushqim (forca ditore) të detajuar: .

- 
- Numri i personave që trajtohen me vaktin e mëngjesit edhe të darkës.
  - Autoriteti Kontraktor të kontrollojë e t'i kërkojë operatorit ekonomik respektimin e orarit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, zbatimin e normave të racioneve të ushqimit, si dhe pastërtinë në ambientet e gatimit të ushqimit dhe të shpërndarjes së ushqimit.
  - Autoriteti Kontraktor, të mos lejojë operatorin ekonomik që të përdorë pajisje për gatim jashtë specifikimeve të kërkuara në këtë shkresë dhe dokumentet standarde të tenderit.
  - Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të titullarit, do të regjistrojë veprimet ekonomike për sasinë e racioneve ditore të prodhuara në ditë të detajuara në numër rendore me një vakt, veprimet për likuidimin e detyrimeve të lindura ndaj operatorit ekonomik do të rregullohen me urdhër të veçantë të titullarit të Autoritetit Kontraktor.
  - Operatori ekonomik/kontraktori do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë javore të ushqimit të miratuar, konform normës bazë të ushqimit.
  - Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë sipas normës bazë të ushqimit.
  - Të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transport të produkteve ushqimore të freskëta si dhe ato të gatuar, të cilat të plotësojnë të gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas standardeve në fuqi.
  - Operatori ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 date 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
  - Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standardeve të kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit HACCP.
  - Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për grupet e vecanta deri te konsumatori, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posaçme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet, si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit të produktit).
  - Operatori ekonomik, të respektojë rregullat e higjenes për larjen, pastrimin, dhe përpunimin e zarzavateve, frutave, sipas kërkesave të ligjeve në fuqi në fushën e higjenes dhe ushqimit.

Operatori për qellime higjenes dhe pastrimi të përdorë detergjentë dhe solucione kimike të certifikuar nga institucionet e njohura me ligj dhe të pa dëmshme për shëndetin e njerëzve të përcaktuara sipas akteve përkatëse.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjenë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave.

---

## Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit 2022, 2023, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mëposhtme "c" të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

**2.2.2** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se **30% të vlerës së fondit limit** që prokurohet nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

---

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtet vendor për shlyerjen e taksave vendore (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

*\*\*\*Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin”.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.1.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se **20% e vlerës së përlogarit** të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

#### **2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë

- Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente/të barazvlefshme – Standart për “Sistemin e menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- Çertifikatë ISO 22000:2018 ekuivalente/të barazvlefshme, çertifikatë e sistemit të Menaxhimit të sigurisë Ushqimore (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

#### **2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me:

- Çertifikatë të menaxhimit për sigurinë ushqimore sipas konformitetit me standartet evropiane **(HACCP)**.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën **(HACCP)**).

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin e tij minimumi 8 (tetë) persona, pjesë e tyre profesionistë si më poshtë vijon:

- a. Të paktën 2 (dy) Kuzhinierë të cilët duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi.

- 
- b. Të paktën 1 (një) Merceolog ushqimi/Teknolog ushqimor, i cili duhet të ketë Diplomë Universitare në nivel Bachelor/Master shkencor në fusha studimi si: Kimi, Teknologji ushqimore, Inxhinieri Kimike.
  - c. Të paktën 2 (dy) ndihmës /kuzhinier të cilët të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi.
  - d. Të paktën 2 (dy) punonjës shërbimi/shofer të cilët të jenë të pajisur me lejen e drejtimit të nevojshëm për realizimin e transportit të ushqimit.
  - e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për trajtimin, përpunimin, shpërndarjen, paketimin e produkteve shtazore dhe jo shtazore.

Shënim: Punonjësi i kualifikuar/certifikuar për trajtimin, përpunimin, shpërndarjen, paketimin e produkteve shtazore dhe jo shtazore mund të jetë edhe i njëjti person me merceolog ushqimi ose teknologun ushqimor/kuzhinier/ndihmës-kuzhinier.

Për të vërtetuar kualifikimet, dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- Çertifikata/kualifikimet përkatëse për specialistët e kërkuar ose diplomë aty ku kërkohet si alternativë.
- Kontratë pune e vlefshme.
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (çerifikimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
- Listëpagesat sipas formularit e-Sig25 për 2 (dy) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Shënim: Kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.4 me të gjithë komponentët e saj do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit dokumentacionin provues të lartpërmendur.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qera **1 (një) mjet transporti ATV**, i cili do të kryejë transportin e produkteve ushqimore e frigoriferike për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

(a) Në rastet kur mjeti është në pronësi: Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit; Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS).

Në rastet kur mjeti është me qera: Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi; Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit; Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS).

(b) Leje higjeno-sanitare per automjetin, lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik e rrethit ku ushtron aktivitetin përkatës, e vlefshme për periudhën e realizimit të objektit të kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën një pajisje isobox termike antibakteriale, për të mundësuar transportin e produkteve ushqimore e frigoriferike brenda ambjenteve të institucionit për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit objekt prokurimi në pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera (vërtetuar me kontratën përkatëse të qerasë të noterizuar të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës).

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) ambjent** ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ qiramarrjen si më poshtë:

---

Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme)
- si edhe Lejen higjeno - sanitare për këtë ambient.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdëklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i AKU-së ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Ndërsa, operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontrates ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se, subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore dhe konform përcaktimeve të bëra në rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së Nr 10181 prot dt 19.11.2018. Gjithashtu, çdo operator ekonomik ofertues duhet ta administrojë këtë dokument, për verifikim, në rast se do të lindi nevoja.

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
5. Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

**Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:**

Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softëerike.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**



---

**Shtojca 10.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
